

NEWSLETTER E DIASPORËS

PERFAQESIMI DHE NIXITJA E POLITIKAVE TE BASHKEPUNIMIT DHE TE NDERVEPRIMIT ME TE GJITHE SHQIPTARET,

DUKE NIXTUR E FUQIZUAR BASHKEPUNIMIN NE TE GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARET JASHTE KUFIJVE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE
DHE SHTETET KU ATA BANOJNE

#16

Ministri i Shtetit për Diasporën vizitë pune në Ukrainë

Ministri i Shtetit për Diasporën zhvilloi një vizitë në Ukrainë, ku ishte i ftuar në një forum diskutimi në Universitetin Shtetëror në qytetin Izmail, ku foli për bashkëpunimin e ngushtë mes dy vendeve. "Ne jemi shumë të interesuar për të krijuar një kohezion në marrëdhëniet e munguara midis shqiptarëve të Ukrainës dhe vendlindjes. Këtë nuk po e bëjmë vetëm për shqiptarët e Ukrainës, kemi filluar një lëvizje të gjerë në të gjithë botën. Përpara pak javësh ne organizuam Samitin e Dytë të Diasporës, ku morën pjesë rreth 1400 pjesëmarrës shqiptarë nga vende të ndryshme të botës. Dëshiroj t'ju them se me shqiptarët e Ukrainës kemi një afritet të veçantë, sepse në rastin e shqiptarëve të Ukrainës ekziston edhe fenomeni i ruajtjes së identitetit pa komunikim me vendlindjen, që për ne është një provë e fortë e ruajtjes së identitetit shqiptar.

Por edhe një provë tjetër e respektit të thellë që ne kemi krijuar për Ukrainën, pasi ka qenë kjo shoqëri ukrainase që ka lejuar që ky identitet të mos asimilohet, por të vazhdojë të ekzistojë. Kjo është arsyeja që në këto vitet e fundit marrëdhëniet midis dy popujve tanë janë forcuar më shumë", u shpreh ministri gjatë fjalës së tij pershendetese. Te pranishëm në forum ishin jo vetëm studentë shqiptarë por edhe studentë ukrainas, të cilët studiojnë kulturën dhe traditat shqiptare.



Ministri në komunitetin shqiptar në Karakurt



Ministri u takua me pjesëtarët e komunitetit shqiptar në Karakurt, Ukrainë në ditën e Shën Gjergjit, gjatë së cilës komuniteti nderon figurën e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Ministri i Shtetit për Diasporën i dhuroi komunitetit abetare, libra për fëmijë në gjuhën shqipe si dhe kostume tradicionale në shenjë falenderimi për ruajtjen e shkëlqyer që i kanë bërë jo vetëm identitetit dhe kulturës shqiptare, por edhe vazhdimësisë së tyre.

"Intervista për mediat ukrainase: Synimi, rritja e komunikimit me shqiptarët e Ukrainës"



Gjatë një interviste dhënë për mediat në Ukrainë, ministri foli për arsyen e vizitës së tij të dytë në Ukrainë, brenda një kohe të shkurtër. "Synimi është për të rritur komunikimin, sidomos me shqiptarët e Ukrainës. Ekzistenca e shqiptarëve në Ukrainë për ne është një arsye më shumë për të pasur marrëdhënie të ngushta me vendin tuaj. Por, ne nuk duam të ngelemi vetëm te vizitat e zyrtarëve jemi duke menduar disa projekte në fushën e arsimit dhe sidomos në fushën e biznesit", tha për mediat ministri Majko.

Gjatë takimit me rektorin e universitetit "Izmail State Humanitarian" në Ukrainë, z.Jaroslav Kichuk, ku u diskutua për mundësinë e bashkëpunimit në arsim



Ministri i Shtetit për Diasporën takon realizuesit e filmit "Arbëria"



Ministri i Shtetit për Diasporën gjatë bashkëbisedimit i përgëzoi për punën dhe idenë e tyre që t'i sjellin publikut një film mbi historinë dhe jetën brenda komunitetit arbëresh, të cilët ndër vite kanë ruajtur traditën dhe kulturën shqiptare. Regjisorja e filmit Francesca Oliveri dhe stafi organizativ ndanë përvojën dhe vështrësitë e punës së tyre gjatë realizimit të këtij filmi. Filmi "Arbëria" tregon historinë e Aidës, një stiliste e suksesshme e cila zbulon origjinën e arbëreshe përmes një udhëtimi në vendet e kujtimeve fëmijërore ku njih gjuhën, traditat dhe atmosferën në komunitetin arbëresh.